



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e neneve 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 si dhe neneve 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.09.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR TRAJTIMIN E QENËVE ENDACAK NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) për trajtimin e qenëve endacak në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të trajtimit të qenëve endacak të cilët vazhdimisht paraqesin rrezik për qytetarët e komunës.

Neni 3

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari për vitin 2022.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 400/01-52761
Lipjan, më 28.09.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

